



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 156, Datë 09.07.2018

MBI

PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 5 gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE me vendimin nr. 108, datë 14.11.2014, ka licencuar shoqërinë “EFT ALBANIA” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “EFT Albania” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 487 Prot., datë 03.07.2018, ka kërkuar nën vullnetin e saj të plotë heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Kërkesa e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, gërma “dh”, “Heqja e një licence”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 58, datë 18.04.2017.
- Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “EFT ALBANIA” sh.p.k për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregimit me energji elektrike me nr. 255 Seria T14, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 108, datë 14.11.2014.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.